

Beqir META

BRISHTËSIA E VENDIMEVE TË KONFERENCËS SË LONDRËS TË VITIT 1913 PËRGGJATË SHEKULLIT XX

Abstrakt

Vendimi i Konferencës së Ambasadorëve në Londër i 29 korrikut 1913, konsiderohet si akti themelor ndërkombëtar i krijimit dhe njohjes ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Por edhe ky vendim është sfiduar nga rrethanat historike dhe më së shumti nga vetë vendimmarrësit e saj të gjithë së bashku, në blloqe politiko-ushtarake ose në shtete të veçanta.

Vendimi ishte një kompromis i vështirë midis dy blloqeve të mëdha politiko-ushtarake, Antantës e cila më së shumti ishte kundër pavarësisë së Shqipërisë, ose për krijimin e një shteti shqiptar tërësisht të reduktuar dhe anemik, i cili do ta kishte të pamundur mbijetesën e tij dhe do të ishte një pre e lehtë për t'u gëlltitur nga fqinjët e tij; dhe Bllokut Trepalësh që përbëhej nga Austro-Hungaria, Italia e Gjermania, të cilat synonin të krijonin një shtet sa më viabël në territoret natyrale që banoheshin tërësisht ose në shumicën dërrmuese nga shqiptarët. Kjo strukturë e Konferencës do të ndikonte edhe në efektivitetin dhe soliditetin e këtij akti ndërkombëtar. Vendimi i Konferencës së Ambasadorëve u sfidua fill pas marrjes së tij.

Sigurisht brishtësia ose më saktë zhvleftësimi final i vendimeve të Konferencës së Londrës, u përfundua me Traktatin e Fshehtë të Londrës të vitit 1915. Ai u sfidua disa herë gjatë Luftës së Parë Botërore, ndërsa sfida më e madhe ishte kur u provua qartë se Konferenca e viti 1913 ishte zhvleftësuar nga Konferenca e Paqes e viteve 1919-1920. Vendimi i vitit 1921 i bëri disa ndryshime vendimit të vitit 1913 ndonëse ruajti thelbin e tij për njohjen ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Sfida më madhore e vendimit të viteve 1923 dhe 1921 si dhe e ekzistencës së shtetit shqiptar ishte agresioni italian i 7 prillit 1939.

Fjalë kyçe: *Konferenca e Ambasadorëve, Londra, Traktati i Fshehtë i Londrës, Lufta e Parë Botërore.*

1. Vendimi i Konferencës së Ambasadorëve u sfidua fill pas marrjes së tij. Sfiduesi i parë serioz dhe i rrezikshëm që provoi se vendimi i Londrës i 29 korrikut 1913 ishte i brishtë dhe se ishte Greqia e cila orkestroi dhe realizoi të ashtuquajturën lëvizja “vorio-epirote”. Ajo ishte e detyruar të njihte vendimin e lartpërmendur formalisht dhe të deklaronte tërheqjen e trupave të saj pushtuese nga Shqipëria e Jugut. Por nga ana tjetër, ushtarë të saj, së bashku me bandat e kriminelëve nga Kreta, të maskuar si kryengritës “vorio-epirotë”, sfiduan ushtarakisht shtetin e ri, duke e detyruar qeverinë shqiptare të pranonte të ashtuquajturin Protokollin e Korfuzit, i cili çonte drejt copëtimit të shtetit të ri të njohur nga Konferenca e Ambasadorëve. Fuqitë e Mëdha, jo vetëm nuk e penguan këtë tragjikomedi, por e sanksionuan atë, madje dhe duke ushtruar presion kundrejt qeverisë shqiptare dhe duke marrë dhunshëm edhe disa kompetenca të saj nëpërmjet Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK). Gjithashtu KNK ndaloi princ Vidin të dërgonte forca ushtarake në Jug për të shtypur forcat greke të maskuara si “autonomiste”.¹

2. Sigurisht brishtësia u dëshmuua më qartë me Traktatin e Fshehtë të Londrës të vitit 1915, ku 4 nga 6 Fuqitë vendimmarrëse në këtë Konferencë, nënshkruan asgjësimin dhe copëtimin e mëtejme të shtetit shqiptar.² Kështu u zhvleftësuan plotësisht vendimet e Konferencës së Londrës.

3. Pas fillimit të Luftës së Parë Botërore edhe Austro-Hungaria e cila kishte qenë mbështetësja kryesore e krijimit të shtetit shqiptar, u fut në negociata me Italinë për copëtimin e Shqipërisë midis tyre dhe gjithashtu zhvilloi negociata me Greqinë për ta tërhequr në anën e saj, duke i premtuar përfitime në Shqipërinë e Jugut.³

¹ Ledia Dushku, *Kur historia ndau dy popuj fqinjë. Shqipëria dhe Greqia 1912-1914*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Kristalina- KH, Tiranë 2012, 257-259; 302-316.

² Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit*, Vëllimi II, Tiranë, 8 Nëntori 1987, dok. Nr. 161, 634-641.

³ Muin Cami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918)*, Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1987, 156-157.

Po kështu veproi dhe Gjermania e cila i premtoi Athinës konstandiniste se do të mbështeste ambiciet e saj territoriale kundrejt Shqipërisë.

4. Gjatë Luftës së Parë Botërore, dy akte të tjera ndërkombëtare dëshmonin zhvleftësimin e vendimit të vitit 1913 dhe këto ishin deklarata austro-hungareze për autonominë e Shqipërisë nën protektoratin e saj e vitit 1917 dhe deklarata e ngjashme italiane.⁴

5. Sfidë madhore ishte mbajtja e ushtrive pushtuese, italiane, serbe dhe franceze brenda territorit të shtetit shqiptar edhe pas përfundimit të Luftës.

6. Ndërsa sfida më e madhe, ku u provua qartë se Konferenca e viti 1913 ishte zhvleftësuar, ishte Konferenca e Paqes e viteve 1919-1920, ku Fuqitë e Mëdha fituese të Antantës si dhe fqinjët ballkanikë u sollën sikur kjo konferencë ndërkombëtare gjithëpërfshirëse të mos kishte ekzistuar. Përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha evropiane e vlerësuan si veprim të parakohshëm njihjen ndërkombëtare të pavarësisë dhe krijimit të shteti shqiptar më 1913. Po kështu edhe propozimet e qeverisë amerikane për aneksimin e Vlorës nga Italia, aneksimin e Gjirokastrës, nga Greqia, për protektoratin italian mbi shtetin e mbetur shqiptar, ishin injorim i vendimeve të vitit 1913.⁵ Për më tepër, tri fuqitë kryesore evropiane iu përveshën punës për zhbërjen e shtetit shqiptar. Dy marrëveshje të konferencës që fatmirësisht nuk u realizuan, Memorandumi anglo-franko-amerikan i dhjetorit 1919⁶ dhe i ashtuquajtur i kompromisi Nitti ose marrëveshja anglo-franko-italiane e 13-14 janarit 1920⁷ cenonin rënd, madje akti i

⁴ HHStA. PA.A. në AIH, Vj. 27-8-819, Teksti i proklamatës drejtuar August Kral nga Ministria e Punëve të Jashtme Vjenë, 21 janar 1917; Marenglen Verli, *Shqipëria në optikën e diplomacisë austro-hungareze (1887-1918)*, Tiranë, Klean, 2014, 350-351 (Proklamata e 23 janarit 1917); A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, vëll. II, dok. Nr. 161, 634-643, Proklamata italiane e shpallur më 3 qershor 1917 nga gjenerali Ferrero në Gjirokastrë.

⁵ Muin Cami, Marenglen Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes (1919-1920)*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, Kristalina-KH, 2015, 215-217, 287-291.

⁶ Owen Pearson, *Albania and the King Zog. Independence, Republic, and Monarchy (1908-1939)*, The Centre for Albanian Studies, London 2005, 133-134; Muin Cami, Marenglen Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes...*, 287-291.

⁷ DBFP, First Series, Vol.II, dok. nr.70, Appendix A, f. 865, Nota e përbashkët anglo-franko-italiane dërguar delegacionit jugosllav, 13 janar 1920; Muin Cami, Marenglen Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes...*, 676-677; Pietro Pastorelli,

fundit e zhbënte tërësisht vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913. Fati i Shqipërisë ishte se Fuqitë fituese dhe aleatët e tyre ballanikë nuk arritën të dakordohen plotësisht për këto propozime dhe për çështjet e tjera të kontekstit Adriatik. Po ky ishte dhe shansi i rikthimit të vendimet e vitit 1913. U desh kundërshtimi amerikan kundër copëtimit të plotë të Shqipërisë⁸ që shkaktoi këtë ngërç, evoluimi i politikës britanike⁹ dhe lufta heroike e shqiptarëve në Vlorë,¹⁰ që të ndryshohej trajektorja zhvleftësuese e vendimeve të Konferencës së Londrës 1913. Madje edhe pas kësaj, në nëntor 1920 kishte ende dilema.

7. Kështu fillimisht Lidhja e Kombeve e hodhi poshtë argumentin e paraqitur nga qeveria shqiptare se shteti shqiptar ishte njohur ndërkombëtarisht *de jure* dhe *de facto* nga Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1913.¹¹ Këtë pozicion ajo do ta ndryshonte vetëm tri javë më vonë, kur Shqipëria do të pranohej në Lidhjen e Kombeve dhe ujdia e vitit 1913 do të konsiderohej e ligjshme.¹²

8. Megjithëkëtë u desh një vit tjetër përpjekje, ankthi e debatesh që Fuqitë e Mëdha të rinjhnin shtetin e pavarur shqiptar, përmes vendimit të një konference tjetër ambasadorësh, tashmë në Paris, i cili u dha më 9 nëntor 1921. Vendimi i vitit 1921 i bëri disa ndryshime vendimit të vitit 1913, ndonëse ruajti thelbin e tij për njohjen ndërkombëtare të shtetit shqiptar.

L'Albania nella politica estera italiana (1914-1920), Napoli, Jovene (ed) 1970, 221, shënimi 47.

⁸ Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore*, vëllimi III (1919-1926), Albin Tiranë, 2001, dok. Nr. 23, 242-248, Notë e Presidentit Wilson drejtuar kryeministrave të Britanisë së Madhe dhe Francës, 10 shkurt 1923; Tommaso Tittoni, Vitori Scialo, *L'Italia alla Conferenza della Pace. Discorsi e documenti. A cura di Amadeo Giannini*, Roma 1921, 157-161.

⁹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëllimi II, Tiranë 2023, 56-59; 82-86; TNA, FO, 371/5729, C16965/580/90, Telegram i FO dërguar Sekretarit të Kabinetit, 25 gusht 1920; TNA, FO 371/4689, C8624/440/19, 17 shtator 1920-10 tetor 1920. N. Guy, *Lindja e Shqipërisë. Nacionalizmi etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*, Tiranë, Pegi, 2012, 276-278.

¹⁰ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. II..., 66-75.

¹¹ Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore*, vëllimi III..., 276, Raport i paraqitur nga Komisioni V në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve lidhur me pranimin e Shqipërisë, Gjenevë, 6 dhjetor 1920.

¹² Po aty, 279-290, Diskutim mbi kërkesën për pranimin e Shqipërisë në Seancën e 28 plenare të Asamblesë së LK, Gjenevë, 17 dhjetor 1920.

- Ai i qethi edhe disa territore të tjera Shqipërisë, duke sfiduar edhe një herë vendimin e vitit 1913.
- Cenoj disi pavarësinë e saj, duke i njohur Italisë një rol specifik në Shqipëri për mbrojtjen e shtetit shqiptar.
- I vetmi akt pozitiv ishte tejkalimi i kontrollit ndërkombëtar mbi shtetin e ri, pra nuk u rinovua ekzistenca e një Komisioni Ndërkombëtar Kontrolli me atributet e atij të vitit 1913, ndonëse një komision hetimor i Lidhjes së Kombeve u dërgua për të ndjekur funksionimin e shtetit të ri dhe zhvillimet politike në vend.¹³

9. Nga ana tjetër, duhet theksuar se vendimi i Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1921 u dëshmuar më solid se ai i vitit 1913. Por edhe ai pati limitet e veta të respektimit, si akt i rëndësishëm ndërkombëtar. Ky vendim ndikoi pozitivisht për konsolidimin relativ të shtetit shqiptar në vitet 1922-1939, por u dëshmuar në disa raste edhe brishtësia e tij. Gjatë krizës së brendshme serioze që kaloi Shqipëria në vitet 1922-1924, jo vetëm që Italia sfidoi në fshehtësi vendimin e vitit 1921, duke nxitur destabilizimin e shtetit shqiptar me qëllim që të fitonte pozita politike dhe ekonomike monopol,¹⁴ por pas kryengritjes së qershorit 1924 dhe destabilitetit të thellë në Shqipëri, edhe Londra shqyrtoi opsionin e rishikimit të vendimit të vitit 1921 pra edhe të vitit 1913.¹⁵ Gjatë viteve 1925-1934 Londra u përpoq të amortizonte përpjekjet sfiduese dhe presionet imperialiste të Italisë ndaj Shqipërisë. Pra, ajo u përpoq të mbronte legjitimitetin e vendimeve të viteve 1913 dhe 1921.¹⁶ Por pas kësaj kohe, ajo u tërhoq nga kjo politikë dhe toleroi politikën agresive italiane që po i sfidonte

¹³ Pranvera Dibra, “Diplomacia angleze dhe vendimi i 9 nëntorit të vitit 1921 për Shqipërinë”, *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë, 2002, 56; Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë, vëllimi I (1912-1939)*, Tiranë, Toena, 2013, 532.

¹⁴ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, vëll. II*, Tiranë, 2023, 187-188, 190; DDI, Settima Serie, Volumi III, Roma: La libreria della Stato, 1959, dok. nr. 88, 58-59.

¹⁵ TNA, FO 371/7330, Raport i Foreign Office titulluar “Albanian Situation”, 28 gusht 1924. Në të thuhej: “është e mundur gjithashtu që në një datë të ardhshme të përcaktohet një skemë me të cilën Shqipëria të vihet nën tutelën ndërkombëtare... Kështu gjërat mund të shkojnë edhe më keq...”.

¹⁶ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX vëllimi III...*, 82-89, 235, 245.

ato.¹⁷ Sfida më madhore ndaj vendimeve të viteve 1913 e 1921 si dhe ndaj ekzistencës së shtetit shqiptar ishte agresioni italian i 7 prillit 1939.

Brishtësia e këtyre vendimeve u shfaq edhe me e qartë kur Britania e Madhe dhe Franca nuk e denoncuan agresionin italian dhe shkeljen flagrante të ligjit ndërkombëtar, e konkretisht të vendimit të konferencave të Ambasadorëve të viteve 1913 e 1921. Për më tepër, edhe gjatë luftës, Britania e Madhe që ishte Fuqia më e madhe antifashiste me ndikim në Ballkan dhe Evropë, si dhe arkitektja e vendimeve të viteve 1913 e 1921, i dhunoi ato. Më 17 dhjetor 1942, ministri i Jashtëm britanik deklaroi në parlament se kufijtë e Shqipërisë do të rishikoheshin dhe diskutoheshin pas luftës; se qeveria e tij do të njihte pavarësinë e Shqipërisë, por kjo nuk do të paragjykonte riorganizimet federative ose konfederative që do të bëheshin në Ballkan pas luftës.¹⁸ Pra, ishin dy cenime të rëndësishme substanciale të vendimit të vitit 1913 dhe të vitit 1921.

Ky qëndrim u shoqërua edhe me disa akte të tjera diskriminuese e sfiduese që cenonin statusin dhe legjitimitetin ndërkombëtar të Shqipërisë të përcaktuara në konferencat e Ambasadorëve më 1913 dhe 1921: me mosnjohjen e një qeverie shqiptare në ekzil si përfaqësuese e Shqipërisë; mosnjohjen e statusit të Mbretit Zog njëlloj si homologët e tij ballkanikë; ndalimi me forcë i tij për t'u angazhuar në luftën antifashiste; ndalimi me forcë i tij për aderimin e Shqipërisë në Kartën e Atlantikut dhe në Kombet e Bashkuara; refuzimi i kërkesës së Shqipërisë për të marrë pjesë në Konferencën e San Franciskos dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara;¹⁹ përpjekja britanike për të lënë një shteg për diskutimin e kufijve të Shqipërisë, në notën e njohjes së qeverisë së Enver Hoxhës më 1945, e cila u dekurajua nga aleatët e saj amerikanë. Pas kësaj ekspezeje mund të shtrohen edhe dy pyetje të tjera: a) Përse ishin të brishta vendimet e konferencave të Ambasadorëve për Shqipërinë? b) Cilat ishin arsytet që vendimi i vitit 1921 ishte relativisht më i qëndrueshëm se vendimi i vitit 1913? Brishtësia e vendimeve të

¹⁷ Po aty, f. 235; TNA, FO 371/18839, R 4791/6790, Legata britanike në Durrës për Foreign Office, 24 gusht 1934.

¹⁸ E. Barker, *British Policy in South-East Europe in the Second World War*, London, Macmillan Press, 1979, 191; TNA, FO 371/33107, Teksti i deklaratës së Sekretarit të Jashtëm, Anthony Eden, në Dhomën e Komuneve, 17 dhjetor 1942.

¹⁹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, vëllimi IV*, Tiranë 2023, 197-201.

Konferencës së vitit 1913 dhe disi më pak e theksuar e Konferencës së vitit 1921 lidhet me një sërë faktorësh të cilët janë të sferës së raporteve ndërkombëtare gjatë shekullit XX, por edhe me faktorë të brendshëm shqiptar, pra me gjendjen politike, arsimore, kulturore dhe shkallën e zhvillimit të kombit shqiptar. Shkak themelor ishte fakti se vendimi i vitit 1913 krijoi një shtet liliput, të dobët që shtrihej në më pak se gjysmën e territoreve të banuara tërësisht ose me shumicë nga shqiptarët (28 000 nga 75-76 000 km²) dhe përmblihte rreth 1/3 e popullsisë shqiptare (700 000 nga rreth 2 milionë banorë).²⁰ Kjo krijoi një disbalancë të panatyrshme me madhësinë dhe potencialet njerëzore, ekonomike, politike dhe ushtarake të shteteve fqinje (Serbisë, Greqisë e Bullgarisë).

Gjithashtu ky vendim preu korridoret ekonomike të komunikimit të trojeve shqiptare me Ballkanin dhe kontinentin evropian, si dhe ndau tregjet natyrale të zhvilluara gjatë shekujve nga zonat që mbeten brenda shtetit të ri. Pra, thelbi dhe substanca e vendimit të vitit 1913 ishte shkaku kryesor i dobësisë së shtetit shqiptar, por edhe i brishtësisë së vetë këtij vendimi i cili do të sfidohej shumë herë në të ardhmen. Për më tepër duke qenë një vendim tërësisht i padrejtë dhe në dëm të kombit shqiptar, ai do të sfidohej nga të gjitha anët: do të sfidohej nga fqinjët agresivë të cilët, duke pasur nën sundimin e tyre popullsi të konsiderueshme shqiptare, u interesonte ta dobësonin dhe kontrollonin sa më shumë shtetin shqiptar, madje edhe ta ricopëtonin e zhduknin atë nga faqja e dheut; do të sfidohej nga Fuqi të Mëdha (rasti i Italisë, Francës, Britanisë së Madhe, Ruisë dhe Austro-Hungarisë gjatë Luftës së Parë Botërore dhe rasti i Italisë dhe Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe gjatë Luftës së Dytë Botërore.); së fundi do të sfidohej edhe nga vetë shqiptarët të cilët nuk do të hiqnin dorë kurrë nga e drejta natyrale dhe legjitime për bashkimin e kombit të tyre të copëtuar në dimensione të thella nga më të thellat në Evropë.

Konferenca e Londrës 1913 u zhvillua në prag të konfliktit të madh botëror dhe të shpërbërjes së “Koncertit Evropian”. Koha provoi se të gjitha palët e konsideruan vendimin e saj të përkohshëm. E. Grey do të deklaronte se ky vendim kishte si synim kryesor të shmangte luftën evropiane. Kështu që, kur ajo filloi, askush nuk u ndje i obliguar ta respektonte më tej atë. Pra, ndonëse pavarësia e Shqipërisë

²⁰ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, vëll. I, Tiranë 2017, 223.*

ishte rezultat i një kompromisi të vështirë ndërkombëtar dhe ishte miratuar nga të gjitha Fuqitë evropiane, ajo do të ishte tepër e brishtë dhe madje fluide.

Brishtësia e vendimit të vitit 1913 lidhet me ndryshimin drastik të balancës së forcave dhe raporteve ndërkombëtare, pothuajse menjëherë pas marrjes së tij. Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore, ndryshimet drastike brenda aleancave të kohës dhe koniunktura e re politike që u krijua në përfundim të Luftës, ishin arsye themelore të minimimit dhe asgjësimit të këtij vendimi. Me fillimin e Luftës së madhe të gjitha palët u ndjenë të çliruara nga respektimi i kompromisit të vështirë që kishin arritur në vitin 1913, madje edhe mbështetësit kryesorë të shtetit të ri, Austro-Hungaria dhe Italia. Për më tepër, Italia ndryshoi anë, duke u bashkuar me Antantën në vitin 1915, çka hodhi tërësisht në erë vendimin e vitit 1913, pasi një nga kushtet e aderimit të saj ishte pikërisht zhbërja e shtetit shqiptar. Përfundimi i Luftës dhe fitorja e Antantës ishte një zhvillim negativ që sfidoi hapur vendimin e vitit 1913.

Tashmë nuk ekzistonin dy Blloqet dhe arkitektura ndërkombëtare e paraluftës, e ndërtuar si rezultat i balancave të fuqisë dhe interesave midis tyre, ishte shkërmoqur. Anulimi apo injorimi i vendimit të vitit 1913 ishte njëra nga shtyllat që do tentohej të rrëzohej. Kjo lidhet me faktin se dy Fuqitë kryesore - Britania e Madhe e veçanërisht Franca, kishin qenë në anën e kundërshtuesve të krijimit të shtetit shqiptar. Për më tepër, Italia që tashmë ishte një fqinj fitues, nuk kishte rival të fuqishëm kundërbalancues në Shqipëri siç kishte qenë më parë Austro-Hungaria, prandaj ajo kishte ndryshuar në mënyrë drastike edhe politikën e saj, duke vënë si objektiv revizionimin fundamental të vendimit të vitit 1913. Pra, situata ishte shumë më e pafavorshme se në vitin 1913 për çështjen shqiptare. Megjithatë ishin krijuar ose fuqizuar disa faktorë të rinj, të cilët, deri diku, do të ndikonin për ruajtjen e shtetit shqiptar, pra edhe të vendimit të Konferencës së vitit 1913. Këta ishin:

- Dalja në skenën botërore dhe evropiane si fuqi e madhe e SHBA-së, e cila nuk ishte e lidhur me traktatet e fshehta evropiane dhe kishte një platformë më demokratike për arritjen e paqes evropiane.
- Vështirësitë në rritje për të arritur kompromis midis Italisë, nga njëra anë, dhe Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene e Greqisë

nga ana tjetër. Ky ishte një rivalitet i ri që kompensonte disi, por jo mjaftueshëm, mungesën e rivalitetit austro-italian para lufte, i cili kishte qenë faktor themelor për krijimin e Shqipërisë së pavarur.

- Pas Luftës ra mjaft interesi i Britanisë së Madhe për të zbatuar Traktatin e Fshehtë të Londrës dhe për të kënaqur orekset territoriale italiane, çka u manifestua në braktisjen graduale të këtij angazhimi, veçanërisht pas qëndrimeve kundërshtuese të presidentit Wilson. Po kështu edhe Franca e kishte rritur rivalitetin me Italinë për dominimin në Mesdhe dhe nuk ishte e interesuar të përkrahte aspiratat italiane, ndonëse ishte e detyruar nga nënshkrimi i Paktit të Fshehtë të vitit 1915.
- Evoluimi dhe konfirmimi i këtyre faktorëve do të ringjallte vendimin thuajse të vdekur të vitit 1913, duke organizuar një konferencë tjetër ambasadorësh e cila konfirmoi, me pak ndryshime, vendimin e vitit 1913.

Megjithëkëtë duhet theksuar se vendimet e Konferencës së Londrës 1913 dhe Konferencës së Ambasadorëve të Parisit 1921 u cenuan nga Greqia gjatë viteve 1923-1926 kur ajo spastroi etnikisht gjithë rajonet e Maqedonisë Perëndimore (Follorinës, Kosturit, Voshtinës, Janinës, Selanikut etj.) nga popullsia shqiptare në kuadër të shkëmbimit të popullsisë greko-turke.²¹

Pas këtyre dy vendimeve ndërkombëtare erdhën sfida të tjera të mëdha që lidheshin me zhvillimin e raporteve ndërkombëtare, të cilat ishin dinamike dhe ndryshuan gradualisht në vitet 1920-1930. Pikësëpari, fuqizimi dhe agresiviteti i dy Fuqive evropiane që mëtonin revizionizmin e sistemit të Versajës ishte faktor kryesor. Rikonfirmimi i Pavarësisë së Shqipërisë më 1921 kishte qenë agregat i këtij sistemi në fillimet dhe njëkohësisht në apogjeun e tij. Por kriza e tij që do të rezultonte në Luftën e Dytë Botërore do të prekte edhe komponentin shqiptar.²² Raporti i Forcave që u krijua gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe në fund të saj, si dhe interesat e ndonjë fuqie të madhe evropiane (Britania e Madhe), sërish krijuan hije dyshimi dhe rreziqe për ruajtjen e vendimeve të vitit 1913 e 1921. Por gjithsesi kjo mbeti vetëm një tendencë, pasi ky element kundërshtues u kundër balancua nga

²¹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëll. II...*, 439-478.

²² Për këtë dëshmon gjithë politika italiane midis viteve 1922-1939.

politikat antirevizioniste të Fuqive të tjera të Mëdha, në radhë të parë nga SHBA-ja.

Gjithashtu rindarja e botës së rish në dy Blloqe ishte një element tjetër i frenimit të tendencave revizioniste kundrejt vendimeve të viteve 1913-1921. Por edhe në fundin e Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj vendimet e Londrës 1913 dhe Parisit 1921 u cenuan sërisht. Mund të konsiderohet një sfidë ndaj këtyre vendimeve spastrimi i plotë etnik i shqiptarëve nga Çamëria në vitet 1944-1945.²³ Gjithashtu, një cenim tjetër ishte edhe ricopëtimi i territoreve shqiptare të ceduara Serbisë nga Konferenca e Londrës dhe dhënia e një pjese prej tyre Republikës Jugosllave të Maqedonisë, që sot përbëjnë Trevat Lindore Shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Sfidat më të madhe historike ndaj vendimeve të Konferencës së Londrës erdhi në fundin e shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI, duke bërë të mundur që jetëgjatësia e tyre të mos e arrinte shekullin. Lufta e NATO-s kundër Serbisë e çlirimi i Kosovës prej saj në qershor 1999 dhe njohja e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 nga SHBA-ja dhe Fuqitë e Mëdha ishte pothuajse zhvlefësimi i këtyre vendimeve. Kjo ishte rezultat i ndryshimit drastik të raporteve ndërkombëtare të shekullit XX, i bashkimit të Evropës që ishte faktori kryesor i këtij ndryshimi. Të gjitha Fuqitë e ish-Bllokut Qendror ose Trepalësh të vitit 1913 dhe 3 nga 4 Fuqitë e ish-Antantës ishin forca kryesore e këtij ndryshimi.

Por do të ishte e pasaktë nëse nuk do të përmendim edhe faktin se vendimet e Konferencës së Londrës të vitit 1913 u sfiduan edhe nga vetë shqiptarët, në kuptimin negativ të fjalës por edhe pozitiv në raport me interesat dhe të drejtat e kombit shqiptar. Mungesa e centralizimit politik, zhvillimi i pamjaftueshëm i ndërgjegjes kombëtare në shtresat e ulëta të popullsisë, nacionalizmi i pazhvilluar në nivelin e duhur, i dobët, i përçarë, struktura sociale e pazhvilluar, veçanërisht ndarjet klanore, krahinore, fetare, mungesa e një klase politike të zhvilluar që të kuptonte dhe të udhëhiqte me qartësi dhe largpamësi procesin e vështirë të shtetformimit, mungesa e një popullsie të arsimuar e me përvojë politike, e të tjerë faktorë të ngjashëm më këto, ishin pengesë e madhe për konsolidimin e shtetit shqiptar gjatë shekullit XX, ishin gjithmonë një rrezik potencial dhe real për zhbërjen e tij, pra edhe të vendimeve të Konferencës së Londrës. Këta faktorë të brendshëm

²³ Shih më gjerësisht Beqir Meta, *Tragjedia Çame*, Instituti i Studimeve për Çamërinë, KLEAN, Tiranë, 2010.

bëheshin edhe më të rrezikshëm pasi amplifikoheshin nga ndërhyrjet gjithfarësh të fqinjëve agresivë. Ngjarje të tilla të dhimbshme si Kryengritja në Shqipërinë e Mesme e viti 1914-1915,²⁴ Lëvizja vorio-epirote në të cilën morën pjesë edhe njaft shqiptarë ortodoksë grekomanë; kryengritjet antiqeveritare dhe grushtet e shtetit gjatë viteve 1921-1924, që kulmuan me kryengritjen e qershorit 1924,²⁵ Lufta civile në vitet 1943-1944,²⁶ ishin ngjarje që rrezikuan seriozisht dhe tërësinë territoriale të shtetit shqiptar. Madje një hije rreziku u shfaq edhe gjatë ngjarjeve të dhimbshme të vitit 1997.

Por shqiptarët do të ishin gjithmonë sfidues ndaj vendimeve të Konferencës së Londrës dhe të asaj të Parisit përgjatë gjithë shekullit XX dhe pas tij edhe në aspektin pozitiv ose afirmativ, pra, të tejkalimit të tyre dhe bashkimit të trojeve kombëtare në një shtet të vetëm. Sfida më permanente do të ishte rritja e ndërgjegjes së tyre, se ata ishin një komb i ndarë padrejtësisht, rritja e dëshirës së zjarrtë për t'u bashkuar në një shtet kombëtar dhe për të jetuar në liri. Kështu gjatë gjysmës së parë të shekullit XX u krijuan organizata e grupe nacionaliste irredentiste ku më e shquara ishte Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës,²⁷ që kishin në thelbin e programit të tyre pikërisht këtë aspiratë. Por ndodhi përgjatë shekullit XX që shqiptarët u përpoqën me armë dhe diplomaci t'i arrinin këto synime. Pikërisht gjatë e në fund të Luftës së Parë Botërore,²⁸ gjatë Luftës së Dytë Botërore²⁹ dhe në momentin e përfundimit të Luftës së Ftohtë. Në dy rastet e para ata u përpoqën të shfrytëzonin tronditjen e sistemit të Versajës në favor të tyre, duke shfrytëzuar Fuqitë që në Londër kishin mbajtur një qëndrim më pozitiv ndaj të drejtave të tyre dhe që pranuan krijimin e një shteti

²⁴ Ferdinando Salleo, *Shqipëria, Gjashtë muaj mbretëri*, Tiranë, Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, Tiranë, 2001. Duncan Heaton Armstrong, *Albania 1914: The Six Months Kingdom-memoires of private secretary of Prince William of Wied*, Tirana, AIIIS, 2001; Thanas Floqi, *Fytyra e vërtetë e Haxhi Qmilit-Kujtime për vitet e mbrapshta (1914-1915)* Tiranë, "55", viti 2008; Mehdi Frashëri, *Kujtime (vitet 1913-1933)*, Tiranë, Omsca-1, 2005, etj.

²⁵ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëll. II...*, 112-121; 221-260.

²⁶ Uran Butka, *Lufta Civile në Shqipëri (1943-1945)*, botim i tretë i plotësuar, Maluka, Tiranë 2023.

²⁷ Lush Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (1918-1924)*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Prishtinë 1997.

²⁸ *Historia e shqiptarëve, vëllimi I...*, 403-429.

²⁹ Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës (shtator 1944-korrik 1945)*, Tiranë 1994; Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore 1941-1945*, Toena, Tiranë, 1997.

shqiptar, të cilit do t'i bashkoheshin shumica e territoreve të banuara në shumicën dërmuese nga shqiptarët, që Konferenca e vitit 1913 ua kishte dhënë fqinjëve. Ata do të dështonin në këto përpjekje pikërisht për arsye se kishin zgjedhur të ndërtonin përpjekjet e tyre, duke u bazuar në mbështetjen e Bllokut humbës të luftës.

Ndërsa në rastin e fundit, ata arritën me sukses që ta reviziononin në themel vendimin e vitit 1913 ndonëse jo tërësisht. Kjo u arrit jo vetëm si rezultat i vullnetit dhe përpjekjeve të paepuara të shqiptarëve por edhe si rezultat i ndryshimeve drastike të raporteve ndërkombëtare kur disa Fuqi evropiane, dikur anëtare kryesore të Bllokut të Antantës, (Britania e Madhe dhe Franca), dy Fuqi të Bllokut Trepalësh (Gjermania dhe Italia), nën udhëheqjen e një Fuqie të Madhe jashtë evropiane (SHBA) pranuan, ndonëse me shumë vështirësi, të reviziononin në themel vendimin e Konferencës së Londrës së vitit 1913. Pra vetëm kur shqiptarët gjetën momentin dhe anën e duhur ku të mbështesnin përpjekjet e tyre thelbi i vendimeve të Konferencës së Londrës 1913 u tejkalua, ndonëse jo e gjithë arkitektura politike që krijoi kjo Konferencë për çështjen shqiptare nuk është zhbërë ende.